

INDEKSI

2017

I TRANSPARENCËS



Shtator 2017



RES PUBLICA



Embassy of the United States of America
Tirana, Albania



Embassy of the United States of America
Tirana, Albania

Ky publikim është pjesë e projektit “*Rritja e aksesit të gazetarëve investigues në informacionin zyrtar*” që mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autor-it/ve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

Botues: Qendra “Res Publica”
Blv. Gjergj Fishta, Nd. 24, H.3, Ap.44, Tiranë, Shqipëri

Përgjegjës dhe përgatitja grafike: Dorian Matlija

© Qendra “Res Publica”, Tiranë, 2017

TREGUESI I LËNDËS

.....5	I. HYRJE
.....6	II. METODOLOGJIA
.....9	III. INDEKSI
.....9	Transparenca Proaktive
.....17	Transparenca Reaktive
.....22	Rezultati Agregat
.....23	IV. TË TJERA
.....26	V. KONKLUZIONE
.....27	VI. REKOMANDIME



I. HYRJE

Ky raport u përgatit nga Qendra Res Publica, me mbështetjen financiare të Programit të Granteve të Vogla i për Demokraci i Ambasadës së SHBA-së në Tiranë.

Res Publica ka një eksperiencë të gjatë në lidhje me të drejtën e informimit, si dhe numëron disa studime në këtë fushë, të shoqëruara me një numër rekomandimesh për përmirësimin e ligjit për të drejtën e informimit dhe zbatimin e tij në praktikë.

Bazuar në studimet e mëparshme, Res Publica ka vijuar monitorimet e institucioneve dhe synon të informojë publikun në lidhje me institucionet më transparente dhe ato më pak transparente.

Monitorimi i institucioneve është bërë nga muaji Shtator 2016 deri në muajin Qershor 2017 dhe renditja e tyre është bërë në bazë të një metodologjie komplekse. Renditja e institucioneve është publikuar online në faqen online www.publeaks.al

Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi se si institucionet publike zbatojnë ligjin për të

drejtën e informimit, duke pasur parasysh jo vetëm publikimin e informacioneve pa kërkesë nga publiku, por edhe si reagojnë institucionet publike ndaj kërkesave për informacion që dërgojnë qytetarët.

Një pjesë e studimit fokusohet te reagimi i institucioneve kur marrin kërkesa për informim nga qytetarët e thjeshtë në ndryshim me kërkesat që marrin nga gazetarët investigues.

Në fund të studimit jepen rekomandime se si ligji mund të përdoret si një instrument i rëndësishëm në duart e gazetarëve investigativ, por edhe cilat janë mënyrat që ligji të përmirësohet dhe institucionet publike ta zbatojnë me efektivitet atë.

Grupi i punës për këtë raport përbëhet:

- Av. Dorian Matlija
- Av. Arbësa Kurti
- Av. Dr. Irena Dule
- Av. Brunilda Qershori

II. METODOLOGJIA

Për realizimin e këtij raporti janë përzgjedhur për t'u monitoruar 100 autoritete publike, të ndarë në mënyrë të barabartë në 5 kategori:

1. *Organe kushtetuese dhe të pavarura;*
2. *Organe qendrore të pushtetit ekzekutiv;*
3. *Autoritete të pushtetit vendor;*
4. *Autoritete që i përkasin pushtetit gjyqësor;*
5. *Institucione varësie të organeve ekzekutive.*

Përzgjedhja përfshiu grupe të ndryshme institucionesh, përfaqësuese të ndarjes së

pushteteve sipas shtyllave kryesore (ekzekutive, legjislativë, gjyqësore), sipas ndarjes së pushteteve në kuadër të decentralizimit, si dhe sipas ndarjes së organeve të administratës, në institucione varësie dhe agjenci të pavarura.

Një nga kriteret e përzgjedhjes ishte edhe rëndësia e kompetencat e tyre. Në praktikë, 100 autoritetet e përzgjedhur janë më të rëndësishmit.

20 organe kushtetuese & të pavarura

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë
Këshilli i Lartë i Drejtësisë
Presidenti i Republikës së Shqipërisë
Kontrolli i Lartë i Shtetit
Gjykata Kushtetuese
Autoriteti Rrugor Shqiptar
Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
Autoriteti i Konkurrencës
Autoriteti i Mediave Audiovizive
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Institutit i Sigurimeve Shoqërore
Komisioni i Ndhimes Juridike
ALUZIONI
Posta Shqiptare
OSHEE
Agjencia e Prokurimit Publik
Universiteti i Tiranës
Komisioneri për të Drejtën e Informimit

20 autoritete vendore

Bashkia Shkodër
Bashkia Tropojë
Bashkia Kukës
Bashkia Lezhë
Bashkia Dibër
Bashkia Durrës
Bashkia Krutë
Bashkia Tiranë
Bashkia Kavajë
Bashkia Elbasan
Bashkia Pogradec
Bashkia Korçë
Bashkia Lushnjë
Bashkia Fier
Bashkia Berat
Bashkia Vlorë
Bashkia Himarë
Bashkia Tepelenë
Bashkia Gjirokastrë

20 autoritete të pushtetit gjyqësor

Gjykata e Lartë
Gjykata Administrative e Apelit Tiranë
Gjykata e Apelit Tiranë
Gjykata e Apelit Shkodër
Gjykata e Apelit Gjirokastrë
Gjykata e Apelit Vlorë
Gjykata e Apelit Durrës
Gjykata e Apelit Korçë
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë
Gjykata e Shkallës së Parë e Krimeve të Rënda
Prokuroria e Përgjithshme

20 autoritete varësie të pushtetit ekzekutiv

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë
Drejtoria e Policisë Qarku Tiranë
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë
Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave
Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
Drejtoria e Përgjithshme Detare
Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve
Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare
Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit
Zyra e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar
Institutit i Shëndetit Publik
Inspektoriatit Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit
Agjencia e Inventarizimit & Transferimit të Pronave Publike

20 organe qendrore të pushtetit ekzekutiv

Kryeministria
Ministria e Kulturës
Ministria e Drejtësisë
Ministria e Punëve të Brëndshme
Ministria e Shtetit për Inovacionin & Administratën Publike
Ministria e Mbrojtjes
Ministria e Shëndetësisë
Ministria e Financave
Ministria e Arsimit dhe Sportit
Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë & Sipërmarrjes
Ministria e Punëve të Jashtme
Ministria e Integritimit Evropian
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
Ministria e Zhvillimit Urban
Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë
Ministria e Energjisë dhe Industrisë
Ministria e Mjedisit
Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural & Administrimit të

II. METODOLOGJIA


Për qëllime studimore, Res Publica e ka ndarë konceptin e transparencës në dy kategori kryesore:

Transparenca proaktive

e autoriteteve publike, e cila manifestohet me publikimin pa kërkesë të një kategorie informacionesh, që ligji e quan “programi i transparencës”

Transparenca reaktive

e autoriteteve publike, e cila manifestohet me kthimin e përgjigjeve të plota dhe brenda afatit ndaj kërkesave për informacion



Sipas skemës së mësipërme, dy kriteret kryesore mbi të cilat bazohet vlerësimi janë:

- Sasia dhe cilësia e përmbushjes së programit të transparencës, dhe;
- Mënyra se si institucionet publike kanë reaguar ndaj kërkesave për informacion.

Të dhënat për studimin janë marrë nga monitorimi i vazhdueshëm i faqeve online të autoriteteve publike, si dhe në bazë të kërkesave për informacion që i janë dërguar, duke ruajtur balancën në numrin e kërkesave drejtuar secilit grup institucionesh.

Vlerësimi/pikësimi është kryer duke vlerësuar pozitivisht dhe negativisht institucionet e monitoruara, sipas një shkalle që shkon nga -100 pikë deri në +100 pikë. Me pikë pozitive është vlerësuar përmbushja dhe publikimi i informacioneve që duhet të përmbajë programi i transparencës. Ndërsa me pikë negative është vlerësuar sjellja penguese e institucioneve kur

ata nuk janë përgjigjur ndaj kërkesave për informacion, duke marrë si komponentë të vlerësimit përgjigjet e plota apo të pjesshme, rastet e refuzimit, respektimin e afatit ligjor, ekzekutimin e vendimeve të Komisionerit, të gjykatave etj.

Vlerësimi është llogaritur mbi bazën e një mesatareje mbi të dhënat që janë mbledhur gjatë periudhës së monitorimit, Shtator 2016 - Qershor 2017.

Në vijim të gjetjeve të nxjerra në monitorimet e mëparshme të zbatimit të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, Res Publica ka monitoruar edhe kërkesat e dërguara nga gazetarët investigues, duke bërë një krahasim mes gjetjeve aktuale dhe ato të monitorimeve të mëparshme.

II. METODOLOGJIA

Për të pasur një tablo të plotë se si funksionon **transparenca proaktive** janë vlerësuar 100 autoritetet publike më të rëndësishëm. Res Publica ka vlerësuar gjithashtu edhe sjelljen e institucioneve në rastin e trajtimit të kërkesave për informacion të dërguara nga qytetarët, gazetarët, aktivistët, etj. Janë dërguar gjithsej 515 kërkesa për informacion, prej të cilave 84 janë pyetje të bëra nga gazetarët investigues.

Ky aspekt është i një rëndësie të veçantë sepse një institucion mund të publikojë shumë informacione pa kërkesë, por nga ana tjetër mund të mos përgjigjet ndaj kërkesave specifike, çka mund të minojë transparencën.

Reagimi negativ i autoriteteve publike është vlerësuar me pikë negative, duke i zbritur ato nga pikët e fituara nga performanca në lidhje me programet e transparencës.

Në përfundim është nxjerrë një rezultat agregat i cili ka shërbyer për të bërë renditjen e përgjithshme të transparencës.

Vlerësimi i kombinuar sjell si rezultat që një autoritet që publikon shumë informacione pa kërkesë mund të renditet më poshtë se një autoritet tjetër që nuk ka program transparence, por që përgjigjet në mënyrë korrekte ndaj kërkesave për informacion. Res Publica e vlerëson **transparencën reaktive** si tepër të rëndësishme për renditjen, pasi ajo ofron pamjen e vërtetë të hapjes së një institucioni, pikërisht kur prej tij kërkohen informacione që vetë institucioni nuk do t'i bëjë publike me nismën e tij.

Gjithsesi, Res Publica ka bërë një vlerësim të barazpeshuar të dyja kategoritë, duke ruajtur balancën në vlerësimin përfundimtar.

100

autoritete publike të monitoruar

515

kërkesa për informim

84


kërkesa nga gazetarë investigues

Një nga risitë që solli ligji për të drejtën e informimit, ishte detyrimi i institucioneve për të bërë publike një kategori të caktuar informacionesh, pa kërkesë nga publiku. Kjo kategori publikohet në të ashtuquajturin *program transparence* (rubrikë e posaçme në faqen e internetit). Modeli i këtij programi është miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit.

Programet e transparencës përfshijnë disa kategori informacionesh dhe dokumentash që për efekt vlerësimi janë ndarë në tre grupe kryesore:

1. Në grupin e parë përfshihen informacione që aksesohen edhe në mënyra të tjera, pasi këto janë më së shumti akte ligjore dhe nënligjore ose informacione që gjenden në to;
2. Në grupin e dytë përfshihen manuale dhe dokumenta të tjera lidhur me aktivitetin e institucionit;
3. Në grupin e tretë përfshihen informacione me karakter më të ndjeshëm, prej nga mund të zbulohen shkelje apo mundësi abuzimi, si prokurimet publike, auditimet, etj.

Fig.1- Indeksi i përgjithshëm i transparencës proaktive të institucioneve Shtator 2016- Qershor 2017



Nga grafiku i mësipërm, rezulton që ka një përmirësim gradual të transparencës proaktive të institucioneve publike. Nga muaji Shtator 2016 deri në muajin Qershor 2017 ndihet një përmirësim i ndjeshëm. Niveli i përmbushjes së programeve të transparencës, që në Shtator 2016 ishte 15%, u rrit në 26.1% në Qershor 2017.

Gjithsesi ky nivel përmbushjeje është tepër i ulët krahasuar me kërkesat e ligjit që dikton masën 100%, aq më tepër që ligji ka 3 vjet që ka hyrë


në fuqi.

Nga renditja rezulton se 5 institucionet më transparente janë Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, Ministria e Zhvillimit Urban, Posta Shqiptare sh.a. dhe Ministria e Mjedisit. Theksojmë që Komisioneri për të Drejtën e Informimit në gjithë periudhën e monitorimit është renditur në vend të parë. Ky fakt vlerësohet për shkak të modelit që duhet të ofrojë vetë Komisioneri, si institucioni përgjegjës për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit.

Institucionet më pak transparente janë Bashkia Tepelenë, Drejtoria Rajonale Arsimore e Qarkut Tiranë, Komisioni Shtetëror i Ndhmës Juridike, të cilët jo vetëm që nuk kanë përbushur programin e transparencës, por edhe kanë pasur

një reagim negativ ndaj kërkesave për informacion, si dhe ndaj ekzekutimit të vendimeve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe/ose vendimeve të gjykatës administrative.

Fig.2 – Indeksi i transparencës sipas kategorive të institucioneve



Kategoria e institucioneve kushtetuese dhe të pavaruara, si dhe kategoria e institucioneve të pushtetit qendror janë në një situatë më të mirë krahasuar me të tjerat. Rritja ka qenë e ngadaltë, ndërsa vihet re një përmirësim i shpejtë në Mars 2017 në pushtetin qendror, pas ndryshimeve të disa ministrave në qeveri.

Ky fakt sugjeron që titullari i institucionit ka rol aktiv, më domethënës se koordinatori për të drejtën e informimit, i cili aktualisht përgjigjet i vetëm para ligjit.

Rritje të ndjeshme në këtë muaj kanë pësuar ministratë sipas tabelës së mëposhtme:

Autoriteti publik	Pikët Shkurt 2017	Pikët Mars 2017
Ministria e Punëve të Brendshme	18	48
Ministria e Energjetikës dhe Industrisë	18	56
Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	14	50
Ministria e Integritimit Evropian	15	44
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	19	50

Një fakt shqetësues që evidentohet është se që nga muaji Maj 2017 ka një frenim të përmirësimit të mëtejshëm, duke ndaluar në një vlerë shumë të ulët, prej vetëm 26.1%. E ndarë sipas grupeve, në fund të muajit Qershor 2017 situata është, sipas tabelës më poshtë.

Nga ana tjetër, kategoria e institucioneve të varësisë ka pësuar një ulje nga 19.2 % që ishte

në muajin Shkurt 2017 në 16.5% në Qershor 2017. Theksojmë institucionet e kësaj kategorie kanë mbajtur qendrim refuzues edhe ndaj kërkesave për informacion, ndërkohë që roli i tyre është tepër i rëndësishëm për qytetarët, sidomos në rastin e drejtorive arsimore, drejtorive të policisë, drejtorive të tatimeve, arkivave, inspektoriateve të ndryshme, etj.

Grupi i autoriteteve publike	Përbushja e programit të transparencës Qershor 2017
Institucione të pushtetit ekzekutiv qendror	36.8%
Institucione kushtetuese dhe të pavarur	33.3%
Institucione të pushtetit vendor	22.8%
Institucione të pushtetit gjyqësor	21.0%
Institucione të varësisë	16.5%

**SHEMBUJT MË POZITIVË DHE ATO MË NEGATIVË
LIDHUR ME TRANSPRENCËN PROAKTIVE**

INSTITUCIONET KUSHTETUESE DHE TË PAVARURA

Komisioneri për të Drejtën e Informimit	71	Këshilli i Lartë i Drejtësisë	20
Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare	70	Presidenti i Republikës	16
ALUIZNI	63	Instituti i Sigurimeve Shoqërore	15
Posta Shqiptare sh.a.	52	Agjencia e Prokurimit Publik	0
Autoriteti i Konkurrencës	49	Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike	0



INSTITUCIONET QENDRORE TË PUSHTETIT EKZEKUTIV

Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore	74	Ministria e Arsimit & Shkencës	21
Ministria e Zhvillimit Urban	63	Kryeministria	17
Ministria e Energjisë	56	Ministria e Drejtësisë	10
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	50	Ministria e Mbrojtjes	3
Ministria e Mjedisit	49	Ministria e Shtetit për Marrdh. me Kuvendin	0

SHEMBUJT MË POZITIVË DHE ATO MË NEGATIVË LIDHUR ME TRANSPARENÇËN PROAKTIVE



INSTITUCIONET E PUSHTETIT VENDOR

Bashkia Korçë	61	Bashkia Tropojë	0
Bashkia Lezhë	49	Bashkia Dibër	0
Bashkia Shkodër	44	Bashkia Tepelenë	0
Bashkia Himarë	38	Bashkia Gjirokastrë	0
Bashkia Vlorë	37	Bashkia Sarandë	0



INSTITUCIONET E PUSHTETIT GJYQËSOR

Prokuroria e Përgjithshme	40	Gjykata Administrative Tiranë	12
Gjykata e Lartë	34	Gjykata e Rrethit Shkodër	4
Gjykata e Rrethit Vlorë	33	Prokuroria e Rrethit Tiranë	0
Gjykata e Rrethit Korçë	32	Prokuroria për Krimet e Rënda	0
Gjykata e Krimeve të Rënda	32	Gjykata e Rrethit Elbasan	0



**SHEMBUJT MË POZITIVË DHE ATO MË NEGATIVË
LIDHUR ME TRANSPARENÇËN PROAKTIVE**

INSTITUCIONET E VARËSISË

Drejtoria e Përgj. Ujësjellës Kanalizime	41	Agjencia e Trajtim të Pronave	0
Drejtoria e Përgj. Shërb. Transp. Rrugor	35	Drejtoria e Kufirit & Migracionit	0
Zyra e Regj. të Pasurive të Paluajtshme	33	Drejtoria Arsimore Tiranë	0
Drejtoria e Përgj. Detare	30	Drejtoria e Policisë Tiranë	0
Drejtoria e Përgj. e Doganave	25	Inspektoriati për Mbrojtjen e Pyjeve	0


INSTITUCIONE QË KANË SHËNUAR PROGRES OSE REGRES TË NDJESHËM

	Nga	Në		Nga	Në
Drejtoria e Përgjithshme Detare	0	30	Agjencia e Prokurimit Publik	40	0
Universiteti i Tiranës	0	35	Drejtoria e Përgj. e Doganave	39	25
Bashkia Lushnje	0	31	Bashkia Dibër	18	0
Bashkia Shkodër	18	44			
Ministria e Punëve të Brendshme	0	49			
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë	0	32			
Gjykata e Apelit Gjirokastrë	0	29			

PËRMIRËSIM

PËRKEQËSIM

Fig. 3 - Shpërndarja e institucioneve sipas pikëve të grumbulluara për transparencën proaktive



Nga grafiku i mësipër rezulton se zhvillimi i programeve të transparencës nuk është i kënaqshëm.

Nga 100 autoritetet më të rëndësishëm kuptojmë se 17% nuk kanë fare një program transparence. Madje disa autoritete nuk kanë as faqe interneti.

Pjesa më e madhe e autoriteteve, siç duket edhe nga grafiku, është vlerësuar me 11 – 50 pikë, që do të thotë se kanë përmbushur më pak se gjysmën e kërkesave të ligjit.


Vetëm 9% e autoriteteve kanë plotësuar më shumë se gjysmën e kërkesave ligjore dhe asnjë autoritet nuk ka arritur të përmbushë plotësisht programin e transparencës.

PËRMBUSHJA E PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS SIPAS KATEGORIVE TË INFORMACIONIT TË PUBLIKUAR

Për të pasur një tablo sa më të plotë, se si është zbatuar programi i transparencës, kemi bërë një nëndarje të programit në 14 kategori informacionesh që rrjedhin nga ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si më poshtë:

A	Informacion për strukturën organizative dhe funksionet e autoritetit publik;	F	Informacion për shërbimet që jep autoriteti publik dhe standardet për cilësinë e shërbimit;
B	Informacion për publikimin e konventave/ligjeve/akteve nënligjore etj.;	G	Informacion për procedurat e ankesave dhe kërkesave etj.;
C	Informacion për procedurat e bërjes së një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozimin e kërkesës dhe procedura e ankimit;	H	Informacion për procedurat ku personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre për hartimin e ligjeve, politikave publike apo ushtrimin e funksioneve;
Ç	Informacion për vendodhjen e zyrave, orarin e punës, emri dhe kontaktet e koordinatorit;	I	Informacion për sistemin që përdor autoriteti për mbajtjen e dokumentacionit publik pa kërkesë;
D	Informacion për arsimin, pagat e funksionarëve dhe detyrat e tyre;	J	Informacion për format e ndihmës shoqërore, subvencionet që jep autoriteti si dhe procedura për t'i përfituar;
DH	Informacion për planet strategjike të punës, raportet e performancës;	K	Informacion në lidhje me informacionin dhe dokumentat që kërkohen më shpesh.
E	informacion për buxhetin, planin e shpenzimeve, raportet vjetore;		
Ë	Informacion për listat e kontratave, shumën,, palët kontraktuese, monitorimi i kontratave;		

Fig. 4 – Përbushja e kategorive të mësipërm të informacioneve në programin e transparencës




Një element i rëndësishëm që konstatohet është se listat e kontratave të prokurimeve, shumën, palët dhe monitorimin e kontratave (pika Ë), i kanë publikuar vetëm nga 13% e institucioneve. Edhe më keq paraqitet situata për publikimin e informacioneve dhe dokumentacionit për planet e punës dhe raportet e performancës (pika DH), që rezultojnë të përbushura vetëm në masën 2%.

Përveç transparencës proaktive, Res Publica ka vlerësuar edhe sjelljen e institucioneve në rastin e trajtimit të kërkesave për informacion të dërguara nga qytetarët, gazetarët, aktivistët, etj. Ky aspekt është i një rëndësie të veçantë sepse

një institucion mund të publikojë shumë informacione pa kërkesë, por nga ana tjetër mund të mos përgjigjet ndaj kërkesave specifike, çka mund të minojë transparencën.

Fig. 5- Indeksi i transparencës reaktive të institucioneve, Nëntor 2016 – Qershor 2017




Nëse për vlerësimin e *transparencës proaktive* kemi marrë në analizë të dhënat e periudhës Shtator 2016 – Qershor 2017, për vlerësimin e *transparencës reaktive* analiza ka nisur në muajin Nëntor 2016, sepse vetëm pas kalimit të afateve procedurale dhe pranimit të ankimeve nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit, Res Publica mund të vlerësonte reagimin e institucioneve ndaj kërkesave për informacion.

Siç rezulton në grafikun e mësipërm, sjellja e institucioneve ndaj kërkesave për informacion nuk ka ndryshuar gjatë të gjithë periudhës, duke

ruajtur një konstante në masën e refuzimit, dhënien e informacionit të paplotë, mosekzekutimin e vendimeve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit, etj.

Në një situatë më të mirë duket se janë institucionet kushtetuese dhe të pavarur, të cilët kanë marrë më pak pikë penalizuese. Grupi që ndjek në vendin e dytë është ai i institucioneve të pushtetit qendror, ndërkohë që institucionet e pushtetit vendor kanë shënuar më shumë pikë penalizuese nga të gjitha kategoritë.

Fig. 6 – Indeksi i përgjithshëm i transparencës proaktive



Nga grafiku i mësipërm, rezulton se indeksi i përgjithshëm i pikëve penalizuese është ulur lehtë, që do të thotë që institucionet kanë përmirësuar reagimin ndaj kërkesave për informacion.

Ky indeks është nxjerrë pas testimit të bërë me një numër të përgjithshëm prej 515 kërkesash për informacion, duke i drejtuar të paktën 4 kërkesa secilit institucion.

SHEMBUJ INSTITUCIONESH ME SJELLJE NEGATIVE LIDHUR ME KTHIMIN E PËRGJIGJEVE

INSTITUCIONET KUSHTETUESE DHE TË PAVARURA

Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike	- 40
Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	- 25
Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE)	- 20
Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale	- 20
Instituti i Sigurimeve Shoqërore	- 20

INSTITUCIONET QENDRORE TË PUSHTETIT EKZEKUTIV

Kryeministria	- 33
Ministria e Energjisë dhe Industrisë	- 26
Ministria e Bujqësisë	- 25
Ministria e Shëndetësisë	- 22
Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore	- 20

**SHEMBUJ INSTITUCIONESH ME SJELLJE NEGATIVE
LIDHUR ME KTHIMIN E PËRGJIGJEVE**

INSTITUCIONET E PUSHTETIT VENDOR

Bashkia Tepelenë	- 50
Bashkia Pogradec	- 40
Bashkia Tropojë	- 24
Bashkia Korçë	- 22
Bashkia Lezhë	- 20

INSTITUCIONET E PUSHTETIT GJYQËSOR

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës	- 50
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër	- 50
Prokuroria për Krimet e Rënda	- 35
Prokuroria e Rrethit Tiranë	- 29
Gjykata e Apelit Tiranë	- 28

**SHEMBUJ INSTITUCIONESH ME SJELLJE NEGATIVE
LIDHUR ME KTHIMIN E PËRGJIGJEVE****INSTITUCIONET E VARËSISË**

Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike	- 50
Inspektoriati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit	- 30
Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë	- 25
Drejtoria e Përgjithshme Detare	- 20
Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit	- 20


INSTITUCIONET E RENDITURA MË MIRË
PAS REZULTATIT TË PËRGJITHSHËM

AUTORITETI PUBLIK	Proaktive	Reaktive	Total
Komisioneri për të Drejtën e Informimit	71	0	71
Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare	70	0	70
Ministria e Zhvillimit Urban	63	0	63
Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore	74	-20	54
Posta Shqiptare sh.a.	52	0	52
Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	49	0	49
Ministria e Financave	47	0	47
Ministria e Mjedisit	49	-4	45
Bashkia Shkodër	44	0	44
ALUIZNI	63	-20	43
Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve	41	0	41
Ministria e Administratës Publike dhe Inovacionit	41	0	41
Avokati i Popullit	41	0	41
Bashkia Korçë	61	-22	39

IV. TË TJERA


CAKTIMI I KOORDINATORËVE & REGJISTRI I KËRKESAVE

Fig. 7 - Caktimi i koordinatorit për të drejtën e informimit



Megjithëse vihet re se shumica e institucioneve e kanë zbatuar detyrimin për të caktuar koordinatorin për të drejtën e informimit, fakti që 22% e institucioneve, ndonëse kanë kaluar 3 vjet nga hyrja në fuqi e ligjit për të drejtën e informimit, nuk e kanë përmbushur ende këtë detyrim, mbetet një element shqetësues. Kjo edhe për faktin se koordinatori për të drejtën e informimit është personi përgjegjës për zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligji.

Fig. 8 – Plotësimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve për informacion




Vlen të theksohet se nga institucionet që kanë një regjistër dhe e kanë të plotësuar, vetëm një institucion ka përgjigje të aksesueshme (Komisioneri për të Drejtën e Informimit), ndërsa institucionet e tjerë kanë publikuar informacionin se është dhënë një përgjigje, por nuk kanë publikuar përgjigjen që i është dhënë kërkuarit.

TRAJTIMI I GAZETARËVE, KRAHASUAR ME QYTETARËT E TJERË


Për të pasur një tablo, se si reagojnë institucionet kur kërkesa dërgohet nga qytetarët në krahasim me kërkesat e hartuara nga gazetarët, më poshtë do bëjmë një krahasim midis këtyre dy kategorive gjatë periudhës Korrik 2016 – Qershor 2017. Krahasimi do të bëhet duke pasur parasysh elementët si: plotësia e përgjigjes, kohëzgjatje e kthimit të saj dhe reagimin e institucioneve pas ankimeve administrative.

Fig.9 - Përqindja e përgjigjeve pas dorëzimit të kërkesës fillestare



Siç vihet re nga grafiku i mësipërm, në rastin e kërkesave të gazetarëve investigues, përqindja e përgjigjeve ndaj kërkesave është pak më e ulët, por në një diferencë të pandjeshme dhe pa relevancë statistikore. Ky fakt sugjeron që kërkesat e gazetarëve investigativë trajtohen me të njëjtin standard, krahasuar me kërkesat e qytetarëve të zakonshëm.


Fig.19- Përqindja e përgjigjeve të plota në raport me ato të paplota, pas dorëzimit të kërkesës fillestare



IV. TË TJERA

TRAJTIMI I GAZETARËVE, KRAHASUAR ME QYTETARËT E TJERË


Fig.10 - Përqindja e përgjigjeve pas dorëzimit të ankimit administrativ



Siç vihet re dhe nga grafiku, në rastin e ankimeve për kërkesa të gazetarëve, institucionet kanë reaguar në një masë ndjeshëm më pozitivisht, duke lëvruar informacionin në 89% të rasteve, krahasuar me 24% në rastin e qytetarëve të zakonshëm, që tregon se pas ankimit të gazetarëve, institucionet publike angazhohen më seriozisht për të lëvruar informacionin e kërkuar.

Në vecanti për gazetarët, Komisioneri për të Drejtën e Informimit na bën me dije se në periudhën Janar 2016 - Qershor 2017, ka trajtuar 122 ankesa nga gazetarët dhe numri është në rritje. Komisioneri ka pranuar 6 ankime dhe në 3 raste ka vendosur gjobë. Vlen të theksohet se në 112 rastet e tjerë ankimet janë zgjidhur me ndërmjetësim, fakt ky që tregon se pas ankimeve, autoritetet publike angazhohen të lëvrojnë informacionin e kërkuar, përpara se Komisioneri të dalë me vendim. Ky fakt është konstatuar edhe në studimin e mëparshëm të Res Publica,

Fig.11- Shpejtësia e përgjigjes ndaj kërkesës fillestare (në ditë kalendarike)



V. KONKLUZIONE

- Gjatë monitorimit të zhvilluar në periudhën Shtator 2016 deri në Qershor 2017, për 100 institucionet konstatohet se përqindja e përbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga ligji për të drejtën e informimit është rritur nga 15.3% në 26.1%.
- Nga renditja rezultojnë se 5 institucionet më transparente janë Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, Ministria e Zhvillimit Urban, Posta Shqiptare, Ministria e Mjedisit.
- Kategoria e institucioneve të pushtetit qendror janë më transparente se katër kategoritë e tjera. Kategoritë e institucioneve të pushtetit vendor, pushtetit gjyqësor dhe institucionet e varësisë kanë pësuar luhajtje gjatë periudhës së monitorimit.
- Institucionet e monitoruar janë përmirësuar në lidhje me publikimin e informacioneve dhe dokumentave pa kërkesë nga publiku. Edhe në lidhje me trajtimin e kërkesave dhe reagimin ndaj tyre, institucionet kanë një përmirësim, ndonëse më të vogël se përmirësimi i programeve të transparencës.
- Mbetet shqetësues fakti që programet e transparencës nuk janë përbushur plotësisht në asnjë prej kategorive që përcakton ligji, dhe sidomos në lidhje me informacionet për kontratat, monitorimin e tyre, auditimet, etj.
- Nuk vihet re ndonjë ndryshim thelbësor për trajtimin e pyetjeve që vijnë nga gazetarët investigues krahasuar me ato të qytetarëve. I vetmi ndryshim që vihet re ka të bëjë me përgjigjet pas ankimit administrativ dhe lehtësisht në lidhje me kohëzgjatjen e kthimit të përgjigjes, ku gazetarët investigues janë trajtuar me përparësi.
- Rezultojnë se caktimi i koordinatorëve, ndonëse ligji ka 3 vjet që ka hyrë në fuqi, është përbushur vetëm nga 78% e institucioneve.
- Problematik rezultojnë plotësimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, ku pak më shumë se gjysma (58%) e institucioneve e kanë një regjistrë për kërkesat dhe përgjigjet për informacion, ndërsa pjesa tjetër prej 42% nuk kanë një të tillë. Edhe nga institucionet që kanë një regjistrë dhe e kanë të plotësuar atë, vetëm një institucion i ka të aksesueshme përgjigjet.
- Një detaj i rëndësishëm i konstatuar gjatë monitorimit, ishte përmirësimi i menjëhershëm i programit të transparencës së disa ministrive në momentin e ndryshimit të titullarit. Ky fakt sugjeron se titullari i një autoriteti publik ka një rëndësi parësore për transparencën, më domethënëse se rëndësia e koordinatorit për të drejtën e informimit, ndërkohë që ky i fundit është i vetmi përgjegjës para ligjit.
- Kohëzgjata mesatare e kthimit të përgjigjeve rezultojnë 18 ditë, e cila është shumë e lartë dhe përtej afatit maksimal ligjor.

VI. REKOMANDIME

Rekomandimi nr. 1

Është vënë re që modeli i miratuar dhe i shpërndarë nga Komisioneri është i njëjtë për të gjitha autoritetet publike, duke krijuar dhe vështirësi në plotësimin e tij, pasi disa nga elementet që kërkohen në programin e transparencës autoriteti publik nuk i disponon. Siç kemi rekomanduar edhe në studimet e mëparshme, duhet të rishihet modeli i programit të transparencës, duke e përshtatur sipas natyrës së autoriteteve publike.

Rekomandimi nr. 3

Vijojmë të rekomandojmë që është e nevojshme që të përfshihet si shkelje administrative mos caktimi i koordinatorit nga titullari i autoritetit publik dhe si rrjedhojë të parashikohet një dënim me gjobë në rastin e konstatimit të kësaj shkeljeje. Shprehim mendimin se duhet të bëhet patjetër një ndërhyrje legjislative me qëllim ushtrimin e presionit ndaj titullarëve të autoriteteve publike që refuzojnë të caktojnë koordinatorin për të drejtën e informimit.

Rekomandimi nr. 2

Rekomandohet të vijojnë trajnimet e koordinatorëve për të drejtën e informimit, sidomos lidhur me programet e transparencës, pasi ata kanë vështirësi për të kuptuar dispozitat e ligjit për të drejtën e informimit dhe në mënyrë të veçantë plotësimin e programit të transparencës.

Rekomandimi nr. 4

Të shtohet presioni kundër autoriteteve publike që shkelin ligjin për të drejtën e informimit, pavarësisht qendrimeve të mëparshme të Komisionerit, i cili duhet të aplikojë ndëshkime ndaj funksionarëve që vazhdojnë të refuzojnë të lëvrimin e informacionit brenda afateve ligjore, nuk plotësojnë programin e transparencës, duke u sjellë si përsëritës të shkeljes.

Lidhur me masat ndëshkuese, rekomandojmë ndryshimin e ligjit për të përfshirë si përgjegjës edhe funksionarë të tjerë që provohet se pengojnë transparencën e autoritetit publik, përfshirë edhe titullarin e tij.

2017

www.publeaks.al

www.respublica.org.al